



## AVOKATI I POPULLIT PROJEKTI DANEZ



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: [+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

### **Informacion mbi zhvillimin e trajnimeve të personelit të burgjeve dhe paraburgimeve në Tiranë, Elbasan dhe Fushë-Krujë.**

Institucioni i Avokatit të Popullit me mbështetjen e Projektit "*Mbështetja e Danimarkës për Avokatin e Popullit Shqiptar - Më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015)*", realizoi tre trajnime të parashikuara për vitin 2014, pjesë e Aktivitetit Nr. 3 "*Trajnimi i personelit në Burgje dhe Paraburgime*" sipas Planit Vjetor të Aktiviteteve të Komponentit Nr. 2 "*Burgjet dhe Qendrat e Paraburgimit*".

Trajnimet ishin dy ditore dhe u realizuan në datat 20 - 21 Nëntor 2014 në Sektorin e Trajnimeve tek Instituti i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve (ISHVB) në Tiranë, në datat 18 -19 Dhjetor në I EVP Elbasan dhe në datat 22 - 23 Dhjetor në I EVP Fushë Krujë.

"*Trajnimi i personelit në Burgje dhe Paraburgime*" u krye në bashkëpunim me shoqatën "Përthyerja" ku morën pjesë dhe u trajnuan rreth 90 punonjës të personelit të Burgjeve dhe Paraburgimeve.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e cilësisë dhe qasja interaktive për të ndryshuar mentalitetin e personelit në burgje dhe paraburgime në çështje të të Drejtave të Njeriut në burgje dhe paraburgime, shëndeti mendor, trajtimi i të paraburgosurve, mekanizmat mbikëqyrës etj.

Në këto trajnime nga Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë Drejtuesja e Mekanizmit Kombëtarë për Parandalimin e Torturës, Znj. Jorida Rustemi, Ksanthipe Kokëdhima përfaqësuese e zyrës së menaxhimit të Projektit Danez, si dhe katër përfaqësues të Shoqatës "Përthyerja" të cilët kryen trajnimet.



Znj. Jorida Rustemi bëri një prezantim të Institucionit të Avokatit të Popullit në Rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në çdo trajnim si dhe shpjegoi me detaje rolin dhe funksionin e MKPT, si dhe mekanizmat që përdoren në funksion të mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut në burgje dhe paraburgime.

Gjithashtu disa nga çështjet që u trajtuan gjatë trajnimeve ishin: sfidat aktuale në lidhje me të Drejtat e Njeriut në burgje, standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut në burgje, shëndeti mendor në burgje, të drejtat e të paraburgosurve, si dhe mekanizmat mbikëqyrës.

Nga pjesëmarrësit u vu re një interesim i lartë lidhur me trajnimin, si dhe pati shumë interaktivitet dhe diskutime, duke marrë kështu më shumë njohuri për punën e Institucionit të AP dhe të praktikave më të mira që institucioni ka.